




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

Nga seanca e VI (gjashtë) e Kuvendit të Komunës mbajtur, më 29. VI. 2012 me këtë:

REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - a. Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes Urbanistike të një pjese të PRRU: "Qarku", (te shkolla e re fillore)
 - b. Propozim vendimi për mënyrën e kompensimit të pronës përmes koeficientit të ndërtimit,
 - c. Propozim vendimi për miratimin e planit inventiv për Infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit në territorin e Komunës së Gjilanit,
 - d. Propozim vendimit për miratimin e zgjidhjes urbanistike të hapësirës publike "Parku "-në lagjen "Arbëria",
 - e. Propozim vendimi për miratimin e Marrëveshjes parimore për kompletimin e ngastrave ndërtimore përmes ndërrimit të kufijve të parcelave dhe rregullimit të marrëdhënieve pronësore-juridike-Zona Fidanishte,
 - f. Propozim vendimi për shpalljen Zonë me interes të përgjithshëm Publik,
 - g. Informatë nga Drejtoria e Arsimit për kriteret e pranimit të nxënësve në klasën e parë të shkollës fillore dhe Informatë për kriteret e pranimit të punëtorëve në arsim,
 - h. Informatë mbi menaxhimin e parkingjeve nga shoqatat e dala nga lufta,
 - i. Informatë në lidhje me tenderët për mirëmbajtjen verore të rrugëve dhe sinjalizimin horizontal dhe vertikal,
 - j. Informatë rreth zbatimit të Marrëveshjes së Komunës me VIVA FRESH, (shfrytëzimi i hapësirës publike te posta e vogël)

3 Të ndryshme,

Seanca i filloi punimet në ora 10.15.min

Kryesuesi i seancës
z. Izmi Zeka

Në punimet e seancës së gjashtë morën pjesë:
Anëtarët e Kuvendit
Kryetari i Komunës

Drejtoret e drejtorive
Përfaqësuesi për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
Përfaqësuesi i OSB-së
Përfaqësuesi i Forumit Demokratik “Anamorava”
Mediet

Seancën e gjashtë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit e hapi dhe udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë duke filluar nga anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, OSB-në dhe të tjerët dhe kërkoi nga sekretaria që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë.

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në sallë janë të pranishëm 38 anëtarë të Kuvendit , kurse mungojnë 3 ; Abdyl Aliu, Tefik Ibrahimimi, Shpresë Hajdari

Procesverbali, nuk pati vërejtje i cili u miratua, por pasi që ishte dërguar në adresë elektronike, çdo anëtarë i Kuvendit nëse ka ndonjë vërejtje, ato mund t’i dorëzojë me shkrim në sekretari.

Lidhur me rend të punës u paraqit:

Arianit Sllamniku- z. Sllamniku së pari i përshëndeti, anëtarët e Kuvendit dhe të gjithë të pranishmit në sallë i cili në vijim theksoi se në mbledhjen e fundit të KPF-së nuk kam qenë i pranishëm si pasojë e një letre të dërguar nga tre anëtarë të Kuvendit si: Leonorë Bunjaku, Selim Selimi dhe Tefik Maksuti në emër të G-3.

Ky dokument për mu është fiktiv, jo valid, por sipas mendimit tim edhe i falsifikuar!

Si pasojë e kësaj, unë sot e kam proceduar lëndën në gjykatë, por kjo do të shqyrtohet edhe në instancat ligjdhënëse komunale. Gjithashtu për këtë informatë mua më është desh ta informoj sekretarinë e Kuvendit, kryesuesin dhe tërë këtë institucion ligjvënës, sepse me këtë rast kemi të bëjmë me disa dokumente fiktive të cilat nuk kanë peshë ligjore duke u bazuar në Marrëveshjen e 27 janarit të vitit 2010 në mes të partive politike.

Me këtë rast kemi të bëjmë me një dokument fiktiv i cili nuk qon peshë dhe dokumenti në fjalë i 27.1.2010 është dokument i cili është nënshkruar nga partitë politike pa KTDP-në, por nëse duhet t’i përmbahemi procedurave ligjore duhet pikërisht këto parti politike të cilat e kanë themeluar G-3 ta shpërbëjnë këtë grup dhe jo deputetët komunal, sepse kjo bie ndesh me parimet e Marrëveshjes politike ndërmjet partive politike e jo deputetëve komunal. Unë edhe në këtë seancë jam në cilësinë e shefit të grupit, sepse dokument të qartë si është formuar G-3 nuk ka për shjëputje të G-3.

Izmi Zeka- marrëveshjet i bëjnë partitë në mes vete dhe kjo është çështje e marrëveshjeve të brendshme dhe ato vendosin sipas interesave të tyre. Në momentin që në sekretari është dorëzuar shkresa që më nuk është shëf i grupit Arianit Sllamniku, ne nuk merremi me te, ajo është çështje e partisë. Në këtë rast ne vetëm e kemi zbatuar një kërkesë të një grupi politik tjetër, sepse ky është obligim i ynë.

Sadudin Berisha- së pari përshëndetje për të gjithë dhe po theksoj se është një kërkesë e kahmotshme, tema të cilin do ta shtroj sot në merë të grupit të LDK-së. Kjo është një kërkesë e cila po ripërsëritet se punimet e Kuvendit të Komunës janë të tipit të mbyllur dhe pa asnjë transparencë të opinionit publik të gjerë.

Kjo nuk ka nevojë të komentohet, sepse është e qartë se TV-të lokale vijnë në seancë nga 5 minuta, marrin opinionet e shkurtra dhe opinionin nuk ka fare informacion më të gjerë dhe fare nuk informohet se çka po ndodh në KK. Nuk është vetëm interesi i 14 anëtarëve të LDK-së e cila është e barabartë me shumicën e partisë në pushtet, por besoj se është kërkesë dhe duhet të jetë edhe kërkesë edhe e pjesës tjetër opozitare që të sigurohet detyrimisht transmetimi drejtpërdrejtë i seancave përmes së paku një TV regjional, apo lokal apo së paku edhe të një apo dy radio të cilat do të mund të jenë në shërbim të qytetarëve për punën e cila po ndodh në Komunën e Gjilanit. Kjo kërkesë konsideroj se me shumë seriozitet duhet të shqyrtohet dhe të zgjidhet patjetër. Në të kundërtën LDK do të jetë vetëm pasqyrë figurative e kësaj përbërje dhe që zëri i saj të mos mund të përcillet në opinionin publik. Pozicioni i saj jo vetëm politik, por dhe institucional ka qenë konstruktiv, por asnjëherë nuk kemi qenë dhe nuk do të jemi mbështetës të vendimeve të cilat jo rrallë janë të paligjshme e që për fatin tonë të keq edhe ministria përgjegjëse që i përcjell punimet këtij Kuvendi asnjëherë deri më sot nuk ka reaguar. Reagimet tona janë përcjell nga këtu, kanë hasur në vesh të shurdhër dhe se opinionin publik në asnjë çast nuk ka informacion se çafër është duke ndodhur. Në këtë drejtim dhe kryesia e LDK-së me shumë seriozitet e ka marrë këtë çështje dhe ka vendosur që seanca e fundit është kjo që ne do të jemi pjesëmarrës në këtë Kuvend dhe që detyrimisht të sigurohet transmetimi i drejtpërdrejtë nga një TV së paku dhe një radio së paku dhe të bëhen punimet e këtij Kuvendi transparente. Kjo është e drejtë dhe detyrim kushtetues e kësaj përbërje e kryetarit të Komunës, kryesuesit i cili detyrim duhet të realizohet ndaj qytetarëve. Ne kemi dal në zgjedhje dhe jemi këtu me votën e lirë të qytetarëve, por qytetari nuk po e di se çfarë vote ka dhënë dhe kujt i ka dhënë dhe për çka i ka dhënë, prandaj duhet mbrojtur interesat e tij të drejtpërdrejta. Po e ripërsërisim pozicionin i ynë do të ndryshojë tërësisht që deri më sot kemi vepruar dhe pse ka qenë kërkesë e vazhdueshme. Kjo duhet të jetë çështje e zgjidhur shumë shpejtë dhe jo vetëm e Kuvendit të Komunës, por dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa ku paraprakisht përcaktohet rendi i ditës për seancë të Kuvendit.

Sokol Haziri- unë do të përpiqem të jem shumë i shkurtër dhe i qartë. E para në Kuvend paska ndodhur një konfigurim i ri dhe do të ishte mirë që të jemi të informuar se a është ky G-3 i ri apo është shpërbërë G-3 i vjetër dhe është formacion i ri. Kjo është çështje e partive politike dhe nuk është e kryesuesit, por në bazë të informacioneve që i kemi po të ishte kështu i vjetri do të ishte G-4 i cili ka mbet me 3 njerëz, por faktikisht është G-3 që ka mbetur me 2 njerëz. Do të ishte mirë këto dilema të sqarohen për hir të informimit tonë dhe çështja e përfaqësimit në Komitetin për Politikë dhe Financa edhe aty do të duhej diçka të rishikohet, por megjithatë nuk është çështje e juaja. Për këtë do të ishte mirë që të kemi një informacion a është grup i ri apo i vjetër?

E dyta unë mbështes plotësisht propozimin që vije nga LDK, për transparencë më të madhe dhe për ta shfrytëzuar mundësinë që mediumet lokale ta transmetojnë plotësisht punën e KK-së, por ne nuk dot të kushtëzojmë se nuk do të marrim pjesë në punime të KK-së nëse nuk transmetohet, por si iniciativë e mbështesim.

Sabedin Kadriu- unë edhe para dy-tri seancave e kam bërë një kërkesë dhe është arsyetuar se ende është herët për të ndodh kjo, prandaj pasi që kanë kaluar 6 muaj, kërkoj edhe nga anëtarët e Kuvendit që të më përkrahin për të marrë iniciativë për ta rishqyrtuar rregulloren për tarifa. Këtë po e them për arsye se ka pasur një rritje enorme të pagesës për lokalet me qira, por dhe jemi marrë vesh që pas gjashtë muajve këtë rregullore duhet ta rishqyrtojmë. Unë e lus kryesuesin që sot ose në seancën e radhës ta fusin në rend të punës këtë çështje. Kjo është një kërkesë e imja, sepse është një rritje enorme e qirasë për m².

Arben Mehmeti- unë kësaj radhe po flas në emër timin personal si anëtar i Kuvendit dhe po lidhem me temën e cila u shtrua këtu e cila ka të bëjë me G-3. Kryesuesi e tha dhe është rregull procedurale që formacionet në komitete të ndryshohen, por prej partive politike të bëhen këto ndryshime. Në rastin konkret që unë po e vërej dhe që e posedoj një dokument këtë, shihet se marrëveshja është bërë prej tri partive të ndryshme dhe vendimi që është marrë është i gupeve nga parti të ndryshme. Është një vendim skandaloz dhe është keq për këtë grup G-3, sepse është i nivelit jashtëzakonisht të ulët dhe në këtë aspekt nuk është mirë për ta sjell Kuvendin në këtë pozicion.

Komiteti për Politikë dhe Financa është komiteti më i rëndësishëm dhe kur bëhen atje ndryshime duhet të bëhen me shumë kujdes. Nuk mund të largohet dikush nga një komitet me një vendim të grupit të partive politike që nuk e kanë bazën ligjore për të bërë ndryshime. Unë e di që PD e ka bazën ligjore për ta ndryshuar kandidatin, sepse ai ka qenë në komitet nga PD dhe për neve janë të pavlefshme dokumentet që i bëjnë G-3 ose G-4.

Zyrtarisht kështu është vepruar deri më tani dhe në këtë formë si qenka vepruar ne nuk kemi pasur njohuri dhe është mirë mos të lejohen këso forma dhe mos të lejohet që G-3 të shndërrohet në një Kuvend dhe të bëhen ndryshime sipas tekeve të njerëzve. Kjo është aq më keq kur ne kërkojmë transparencë në raport me publikun dhe vendimi i këtij G-3 ia mbyll gojën anëtarëve të Kuvendit. Këtu shprehimisht thuhet se për shkak të paraqitjes në medime publike është larguar një anëtar nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

Kjo ndodh vetëm në KK- të Gjilanit. Ka qenë desh të pranohet si shkresë, por ka qenë desh të debatohet në komitet dhe Kuvend dhe pastaj të bëhet ndryshimi.

Për mua si anëtar i Kuvendit është skandaloze një veprim i një grupi politik.

Izmi Zeka- sa i përket medieve LDK, ka të drejtë, por ato e përcjellin punën e Kuvendit , qytetarët janë të lirë për të prezantuar, por ne nuk mund ta obligojmë askënd që të prezantojë në punime të seancës. Transparenca që ka ndodh në këtë institucion nuk ka ndodhur në asnjë qeveri dhe në asnjë legjislacion.

Këto janë TV private në Gjilan e të cilat e kanë të drejtën e vet me të cilat mund të bëjmë marrëveshje për t' i përcjell seancat me pagesë, të cilën mundësi nuk e përjashtojmë.

Mirëpo për transparencë të Kuvendit të administratës mos u thirrni fare, sepse nuk e di as vetë se çka mund të bëjmë më tutje.

Sadudin Berisha- nëse i thuhet transparencë asaj që të vijne mjetet e informimit në vullnetin e tyre, kur KK dhe kryetari i Komunës është i obliguar të sigurojë transparencë?

Ju e dini se në të kaluarën në këtë Kuvend janë përcjell gjatë tërë kohës seancat e Kuvendit nga radiot dhe TV –të lokale. Kujtoj se është detyrim moral, institucional dhe ligjor që KK që të ketë marrëveshje me një së paku prej televizioneve lokale për të siguruar transparencë të drejtpërdrejtë të punimeve të Kuvendit dhe me një radio lokale.

Izmi Zeka- ne për këtë transparencë kemi marrë çmim, këtë nuk e kemi propozuar ne, por këtë e ka vlerësuar dikush tjetër Ekzistojnë disa parametra që vlerësojnë se kemi ec mirë. Çështja e TV-së është edhe e buxhetit, por ne do ta kemi në konsideratë këtë kërkesë.

Qemajl Mustafa- kërkesa është legjitime dhe ka të bëjë me avancimin e transparencës dhe ka të bëjë me ofrimin e mundësisë të jetë i informuar secili qytetarë në shtëpinë e tij për gjithë aktivitetin e Kuvendit dhe shërbimit civil. Mirëpo duhet dalluar atë që është transparencë bazuar në ligj dhe duhet dalluar këtë kërkesën tjetër që është e LDK-së e që ka të bëjë edhe me fuqinë materiale për të lidhur kontratë me dike për ta bërë atë transmetim.

Duhet ta dimë se me ligj askund nuk shkruan se KK- të janë të obliguara që ta bëjnë një transmetim të tillë, por ne e kemi bërë më 2008 dhe 2009 dhe e di se Radio Energjia e ka bërë një transmetim të drejtpërdrejtë, më kujtohet se TV – “Vali” ka regjistruar dhe transmetuar të tërë seancën prej fillimit deri në fund. Ne absolutisht jemi të hapur në këtë drejtim dhe do të shohim mundësitë për një gjë të tillë.

Izmi Zeka- rregulloren për të cilën e propozoi Sabedini do të shikojmë mundësinë që ta debatojmë në seancën e radhës. Ndryshimet i bëjnë partitë, prandaj ne nuk mund të përzihemi në këto punë. Propozoj të kalojmë në rend të punës dhe kërkoj që të deklaroheni se kush është për këtë rend të punës për të cilin jemi marrë vesh në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Miratohet rendi i punës me vota unanime të anëtarëve Kuvendit

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

A.. Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes Urbanistike të një pjese të PRRU: “Qarku”, (te shkolla e re fillore)

Bahrie Mahmuti- me këtë rast është propozuar revidimi i hapësirës së ngushtë shkollore e cila ka qenë e planifikuar me planin e Qarkut. Mirëpo me rastin e shpronësimit për shkollën fillore e cila është në fazën përfundimtare, është bërë një ndryshim i parcelave.

Në vazhdim të fjalës drejtoresha dha sqarime edhe më detale të cilat sqarime anëtarët e Kuvendit i kanë në material të seancës.

Në vijim të fjalës së saj drejtoresha e DUMM këtë projekt e sqaroi para anëtarëve të Kuvendit me anë të kono-projektorit.

Jakup Bajrami- unë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa i kam dhënë disa vërejte të mia personale sa i përket kësaj shkolle dhe sipërfaqes së saj dhe eksproprijimi që është bërë. Mendoj se ka qenë një qëllim i mirë me një sipërfaqe adekuate e cila iu ka përgjigj terrenit që ekziston atje.

Të gjitha ato shpenzime janë bërë për ta ruajtur atë projekt dhe atë planifikim të viteve 70.

Ndërtimi i tri-katër shtëpive është bërë me një ndërhyrje antiligjore, por më vonë janë legjitimuar.

Për këtë arsyeje çdo lëvizje çdo shkurtim i sipërfaqes në atë vend tash, ne i shkurtojmë mundësitë për krijimin e kushteve për hapësirë jo të mjaftueshme të shollave tona.

Unë nuk e shoh të arsyeshme të ndërhyjmë në këtë formë, të marrim hapësirë shkollore dhe ta shndërrojmë në hapësirë private.

Unë jam kundër kësaj, sepse kemi dhënë mjaft para për atë tokë që e kemi blerë.

Gjithashtu edhe z., Bajrami kërkoi që të hapet kino-projektori i cili edhe më gjerësisht e elaboroi projektin duke dhënë sqarime pse LDK dhe ai personalisht është kundër këtij propozim vendimi duke konsideruar se kjo nuk duhet të aprovohet.

Qemajl Mustafa- unë jam i mendimit se do të duhej që kjo pikë të mbetet për seancën e ardhshme, sepse po vërehet se ka disa paqartësi. Pa një debat më detal në mes të DUMM, të menaxhmentit të Komunës dhe DA nuk dot ë duhej kjo çështje të kalojë kështu lehtë, sepse sot e kemi rastin e vetëm për ta ndal atë zonë, pavarësisht asaj që Komuna i ka shumë mundësitë e vogla për shpronësim. Po e dhamë sot nuk do ta kemi më kurrë për shkollë. Për këtë arsyeje unë nuk jam i thartar i ngutjeve, të bisedojmë brenda javës së ardhshme dhe ta marrim një konfirmim të shkruar nga DA. Nëse DA thotë se këto 80 ari që kanë mbetur për shkollën është e mjaftueshme për t’u zhvilluar shkolla për shumë

decenie të ardhshme, atëherë ka mundësi të zhvillohet si zonë private, por për ndryshe duhet të marrim qëndrim të shpejtë dhe të prerë për shpronësim të asaj zone dhe t'ia bashkëngjisim edhe atë zonë shkollës.

Bahrie Mamuti- duke pasur parasysh edhe ndërtimin e shkollës në Qark e cila tash punon me një ndërrim, por edhe kjo shkollë do të punojë në një ndërrim, ne duke pasur parasysh kapacitetet e nxënësve për një ndërrim i kemi bërë analizat dhe kemi ardhur në përfundim se hapësira shkollore dhe duke pasur parasysh standardet e zhvillimit në mësim është diku 560 nxënës sipas klasave që i përmban shkolla. Kështu që, standardet 1.5 deri në 2m² për një nxënës, në këtë shkollë del sipërfaqja 1.6 për kokë të një nxënësi.

Nga kjo kemi ardhur në përfundim se sipërfaqja aktuale i plotëson kushtet për këtë numër të nxënësve. Në këtë zonë janë paraparë edhe disa objekte shkollore dhe ne mendojmë se kjo hapësirë shkollore i plotëson kushtet.

Izmi Zeka- të jetë së pari një marrëveshje me DUMM dhe DA-në.

Qemajl Mustafa- standardet botërore kërkojnë tokë të mjaftueshme për aktivitet e shkollës, por tjetër është ajo pse ne jemi të tkurrur. Dihet se në çfarë gjendje është Shkolla “Thimi Mitko” ose “Musa Zajmi”.

Duhet të angazhohemi për të pasur sa më shumë hapësirë për zhvillim të të gjitha aktiviteteve, sepse nuk luan shumë rol edhe numri i nxënësve se a do të punojë ajo shkollë në një ndërrim apo dy, por janë me shumë rëndësi aktivitet jashtë objektit për të pasur hapësirë sportive për të pasur zonë të mjaftueshme.

Unë jam për atë që të kthehet dhe ridiskutohet me DA dhe natyrisht me mundësitë buxhetore të Komunës. Unë e di që nuk kemi mjete të mjaftueshme për shpronësim, por ligji lejon deri në 24 muaj pagesën e shpronësimeve, prej momentit kur bëhet shpronësimi.

Izmi Zeka- unë propozoj që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës pas debatit që do të bëhet me DA-në. Ju lutem të deklaroheni kush është për këtë propozim

Miratohet unanimisht propozimi që pika (a) e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e zgjidhjes Urbanistike të një pjese të PRRU: “Qarku”, (te shkolla e re fillore), të shtyhet për seancën e ardhshme me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

B. Propozim vendimi për mënyrën e kompensimit të pronës përmes koeficientit të ndërtimit,

Bahrie Mahmuti- - ky propozim vendim ka rrjedh nga nevoja e shpronësimit të hapësirave publike e të cilat realisht janë hapësira private, por me destinim janë hapësira publike. Në mungesë të buxhetit për shpronësim kemi ardhur deri te një propozim –vendim që hapësira e cila është e destinuar për sipërfaqe publike të merret nga investitori privat, mirëpo të kompensohet në llogari të koeficientit të ndërtimit. Mirëpo ky koeficient i ndërtimit të mos jetë më i madh se 20%.

Arsyetimet edhe më detale, anëtarët e komitetit i kanë edhe në material të seancës.

Sadudin Berisha- po ndihet nevoja për zgjidhje të natyrshme dhe të qëndrueshme të cilat mund të justifikohen, por një justifikim i tillë gjithmonë duhet të jetë i bazuar në atë që ne e kemi bërë dhe miratuar në këtë Kuvend. Në vitin 2008 e këndej kemi miratuar një sërë planesh urbanistike të cilat thuaja se janë miratuar njëzëri.

Tani kemi këtu një propozim –vendim për mënyrën e kompensimit, kur dihet se mënyra e kompensimit për eksproprijim dhe shpronësim është e përcaktuar qartë dhe proceduralisht e rregulluar me ligjet në fuqi. Pamundësia buxhetore të cilën e kuptoj se është e vogël për të bërë shpronësime dhe eksproprijime që shërbejnë për interesa publike, nuk mund të justifikohet me kompensim të lejimit të ndërtimit me plus 20 apo 10 apo 100%.

Kjo mënyrë e kompensimit bie në kundërshtim me vendimet që ne i kemi miratuar dhe një vendim i tillë do të krijojë hapësira dhe justifikimi i tillë për hapësirat publike dhe private ligjërish nuk mund të ekzistojnë, por kjo është mbi bazën e vendimeve që mund të miratohen sot me shumicë dhe jo me ne. Kjo do të mund të dërgonte deri te ndërrimi i dhunshëm i planeve urbanistike dhe rregulluese. Kjo mënyrë e kompensimit me shtesa të ngritjes së etazhitetit së pari është në kundërshtime me vetë planet rregulluese urbanistike.

Neve na vije çudi që kjo çështje është propozuar nga DUMM e që ne i kemi miratuar propozimet e tyre dhe për neve një gjë e tillë është e papranueshme. Për të ndodh një gjë e tillë duhet të ndërrohet çdo gjë në planet urbanistike, të respektohen procedurat e caktuara për të krijuar një mundësi justifikimi dhe në interes të qytetarëve për ndërtime komerciale dhe ekonomike. Për këtë arsyeje grupi i LDK-së konsideron se kjo bie ndesh me çdo akt të këtij Kuvendi dhe ligjeve në fuqi dhe ne sit ë tillë nuk mund ta pranojmë.

Florinë Zymberi- ne në komitetin e Urbanizmit e kemi shqyrtuar këtë pikë të rendit të punës dhe kemi marrë qëndrim pozitiv. Unë për këtë do të mundohem të jap arsyetime profesionale për këto qëndrime të cilat besojmë shumë se do të ndikojnë pozitivisht dhe do t' i ndihmojnë qytetarët që të kenë shërbime më të mira.

Këtu është fjala për kompensimin e pronave private ku ka ndërhyrje te plani urbanistik dhe planet rregulluese. Ju e dini se forma më e mirë ishte sikur Komuna të kishte buxhet për t' i kompensuar pronat që i merren qytetarit. Mirëpo kjo nuk është e mundur, sepse nuk lejon gjendja ekonomike në të cilën gjendje jemi aktualisht. Për këtë arsye janë propozuar këto kompensime deri në 20% të rritjes së koeficientit të ndërtimit. Me këtë propozim Komuna nuk do të ketë nevojë të jap mjete për shpronësim, por do të kompensohet me prona, të cilat prona janë me interes të përgjithshëm. Kjo është një formë e bashkëpunimit me qytetarë për të mos penguar proceset zhvillimore.

Ne jemi të vetëdijshëm për shtimin e popullatës, rritja e dendësisë së banimit, ndërhyrjet në zonën e planifikuar më herët etj. Mirëpo anët pozitive janë se me këtë vendim do të përfitojnë pronarët e hapësirave më të mëdha ndërtimore, por edhe Komuna do ta mbush arkën buxhetore. Duke u bazuar në këto gjëra, mendoj se duhet miratuar këtë propozim – vendim për të mirën e dyanshme.

Bahrie Mahmuti- ne mendojmë se kjo do të vije në konsiderim në qendër të qytetit, te pjesët e rrugëve publike dhe trotualet., aty ku është e nevojshme. Mirëpo te pjesët e tjera të planeve rregulluese ku zotëria mendon se do të ketë ndërhyrje në plan, ajo nuk do të vije në konsiderim, sepse ato janë zona të lira, ende të pandërtuara dhe hapësirat e rrugëve do të vijnë në konsiderim me hapje dhe me shpronësim të përgjithshëm. Ky propozim me 20% nuk është në kundërshtim me planet rregulluese, sepse planet rregulluese janë format e koeficientit të ndërtimit. Nuk vije në konsiderim që të ndryshojë vija ndërtimore, destinimi nuk ndryshon dhe nuk është ndesh me planet rregulluese. Është pra vetëm rritja e koeficientit të ndërtimit për 20% të rritjes së sipërfaqes në etazhitet.

Qemajl Mustafa- nuk ndryshojnë vija as në zonën e ngushtë urbane as përtej asaj zone. Absolutisht në planet rregulluese nuk ndryshon asgjë. Mendje nuk ndryshon as vije rregulluese as ajo ndërtimore. Fjala është te zona urbane, ku toka kushton shumë. I merret

një pjesë e tokës pronarit dhe epet me deklaram të tij në pronësi të KK-së dhe për kompensim ne ia japim atë 20% në etazhitet. Kjo është e qartë dhe kjo ndodh vetëm në raste të veçanta shumë specifike si në rrugë, trotuar etj.

Sadudin Berisha- unë e kam shumë të qartë dhe e thash se ne e kemi miratuar një plan detal urbanistik edhe për atë pjesë dhe zhvillimi mund të ndodh ashtu si e kemi miratuar. Kjo për të bërë kompensim për pjesët që duhet të eksproprijohen të hapësirave që duhet të shërbejnë për interesa publike, gjejnë një formë e cila nuk do të duhej të jetë formë e kompensimit, sepse një gjë e tillë nuk parashihet me ligj. Së dyti bie në kundërshtim me planin e miratuar edhe në etazhitet, nëse një ndërtim është planifikuar P+3, kurse tash të jetë P+4.

Sokol Haziri-. Unë shumë shkurt po i paraqes qëndrimet e AAK-së dhe jemi shërbyer me një fjali të vetme në Komitetin për Politikë dhe Financa se ne marrim tokë dhe japim ajër, prandaj ne e mbështesim.

Arben Maliqi- mua së pari më erdhi mirë që pikën e parë të rendit të punës e anashkaluam dhe gjëra të tilla duhet të ndodhin definitivisht. Sa i përket pikës së rendit të dytë unë po habitem me faktin aty ku kryetari i Komunës e ka zyrën, aty te bukëpjekësi të cilit ia kemi marrë një pjesë dhe ka qenë desh t'ia japim hapësirën. Është mirë që ne t'ia lirojmë trotuaret që nxënësit të qarkullojnë lirshëm dhe kjo për mendimin tim është shumë e qëlluar dhe këso gjëra duhet të ndodhin në ato vende ku frekuenca është e madhe dhe është pamundësia që Komuna t'ia kompensojë ato hapësira, por t'ia japin atë 20%. Ne si grup e mbështesim dhe e miratojmë këtë propozim-vendim.

Izmi Zeka- të deklaroheni se kush është për miratim të këtij propozim-vendimi?

Aprovohet pika (b) e renit të punës: Propozim vendimi për mënyrën e kompensimit të pronës përmes koeficientit të ndërtimit, me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 12 ishin kundër.

C. Propozim -vendimi për miratimin e planit inventiv për Infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit në territorin e Komunës së Gjilanit,

Izmi Zeka- z. kryesuesi për sqarim të kësaj pike fjalën ia jep drejtoreshës së DUMM, znj. Bahrie Mahmuti.

Bahrie Mahmuti –ky është një pan investiv në aspektin e infrastrukturës për ujësjellës dhe kanalizim dhe është një komponent e cila bazohet në planin zhvillimor komunal. Në këtë plan janë hartuar në pika të shkurta kjo komponent. Për këtë plan është formuar një komision brenda Komunës i cili komision ka hartuar këtë plan investiv për tërë territorin e Komunës së Gjilanit. Për sqarime më detale fjalën do ta ketë anëtari i cili ka qenë pjesë i këtij komisioni dhe zyrtarit për mjedis Fehmi Agushi.

Fehmi Agushi- grupi punues i cili është formuar me një vendim nga kryetari i Komunës ka përpiluar këtë plan inventiv me qëllim që të përpilohet mundësia e çështjes së infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit.

Këtë plan z. Agushi një kohë të gjatë e elabroi me anë të projektorëve para anëtarëve të Kuvendit.

Ramiz Ramadani-. unë jam anëtarë i Komitetit për Planifikim Urban dhe kam pasur rast për ta shpalos ne detale projektin dhe kemi pasur edhe kopje digjitale dhe besoj se pjesa dërmuese këtë plan e konsiderojmë me interes shumë të madh për Komunën e Gjilanit.

Është një plan afatgjatë për të cilin mendohet që prej tash dhe deri në vitin 2022 është në plan për t' u realizuar dhe mendojmë se edhe ato fazat buxhetore prej gjithsejtë 100 milion euro duhet të jenë të realizuara. Ajo që dëshiroj që të plotësoj te ky plan është se në tabelën numër 1 te zonat rurale, parashihen zgjidhje për të gjitha këto zona, por në Llasticë është një lëshim, sepse në fshatin Llasticë thuhet se kapaciteti i ujit është 4 litra në sekondë, por në fakt të gjitha shpimet aty kanë dështuar dhe asnjëherë nuk ka funksionuar ujësjellësi.

Për këtë arsyeje ne kërkojmë një zgjidhje të re e cila duhet të përfshihet në këtë plan.

Për neve është një zgjidhje nga fshati Pasjan i cili ka më pak se dy kilometra me të cilin mund të lidhet deri tek rezervuari i fshatit Velekicë dhe kjo do të ishte zgjidhje e përhershme.

Pasi që në këtë plan parashihet edhe ndërtimi i dy pendëve, asaj në Llapushnik dhe te Shushët, mendoj se në plan qysh tash duhet të parashihen kapacitete të mjaftueshme të ujit jo vetëm për pije, por të parashihet edhe ujitja e tokave të Anamoravës. Kjo është një zgjidhje e mirë dhe nëse e bëjmë një investim kaq kapital, ta bëjmë ashtu si duhet dhe ne e mbështesim dhe e konsiderojmë si plan me interes.

Florinë Zymberi- ky është një plan shumë i qëlluar, sepse uji është elementi më vital dhe më i nevojshmi për jetë. Kësaj kërkesë shumë të nevojshme i ka paraprirë USAID-i Amerikan dhe Zyra Zvicerane. Kjo është një përparësi për të ardhmen, sepse hulumton burimet ujore, ruan natyrën dhe krijon lehtësime për investitorë të jashtëm dhe të brendshëm. Mendoj se duke e ditur rëndësinë e këtij projekti të gjithë duhet të jemi unik dhe ta aprovojme njëzëri.

Arben Maliqi- së pari dëshiroj që të zbatohet në praktikë, sepse në të vërtetë është një ndër projektet më madhore dhe me interes të jashtëzakonshëm për qytetarët e Komunës së Gjilanit. Ne e dimë se shumë fshatra nuk kanë ujë të mjaftueshëm si është edhe fshati Kosaq dhe nëse zbatohet ky projekt do të jetë projekti më madhor i cili do të ndodh në Komunën tonë. Unë e përgëzoj këtë projekt dhe presim ditë të mira.

Sami Hoxha- është një projekt për të cilin kemi dëshirë që të gjithë që të realizohet, sepse është një projekt i cili iu shërben të gjithë qytetarëve. Mirëpo kërkoj nga zyrtari i cili e prezantoi projektin që nëse ka mundësi të hapin sllajdin aty ku ishin projektet e ujit?

E kam fjalën për fshatin Cernicë dhe më intereson që sa kohë është duke u punuar dhe deri ku është arrit me punë, sepse aty ka mbet gjendja e pandryshueshme. Mua më intereson se sa është bërë puna aty?

Tahir Arifi- unë e përshëndes këtë pjesën teorike të punës e cila është bërë, duke dëshiruar që edhe pjesa praktike të realizohet në këtë mënyrë! Mirëpo unë i kam dy çështje të cilat po i aktualizoj: e para është se nuk e kam të qartë që këto fazat e zbatimit të cilat janë paraparë janë bërë në gjendje faktike dhe në vendet ku ka nevojë më urgjente për të intervenuar apo jo? Këtë duhet pasur parasysh. E dyta unë nuk e pash që janë përfshirë fshatrat Buricë dhe Lipovicë në këtë projekt, sepse atje ka edhe burime ujore, por janë edhe disa biznese që po zhvillohen, por është edhe një numër i shtëpive jo i vogël dhe nuk pash që ka ndonjë plan për këto fshatra?

Fehmi Agushi- sa i përket pyetjes së Sami Hoxhës për fshatin Cernicë është një plan në proces dhe ne duhet të gjejmë burime të mjaftueshme të ujit.

Izmi Zeka- kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se kush është për aprovim të këtij propozim –vendimi. Sa i përket fshatrave Buricë dhe Lipovicë me siguri edhe këto fshatra janë të përfshira në këtë plan.

Aprovohet pika (C) e rendit të punës: Propozim -vendimi për miratimin e planit inventiv për Infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit në territorin e Komunës së Gjilanit, me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

D. Propozim vendimit për miratimin e zgjidhjes urbanistike të hapësirës publike “Parku “-në lagjen “Arbëria”,

Bahrie Mahmuti- sa i përket propozim- projektit “Arbëria”, DUMM një kohë të gjatë ka punuar me mjaft përkushtim lidhur me propozim zgjidhjen e këtij lokacioni. Në këtë plan kanë kontribuar dhe qytetarët të cilët i kanë dhënë propozimet e tyre të drejtpërdrejta në këtë planifikim të kësaj zone të gjelbër. Në bazë të takimeve me qytetarë ne kemi ardhur deri te propozim zgjidhja e disa skenarëve dhe kështu e kemi miratuar një zgjidhje më të favorshme. Në vazhdim të fjalës së saj drejtoresha dhe sqarime për secilën zonë veç e veç.

Arben Maliqi- unë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa e kam thënë që Komuna e Gjilanit jo rastësisht ka marrë dhjetëra mijëra euro nga USAD-it për këto zona të gjelbëruar të cilat po i krijon, prandaj edhe ne përgëzojmë për këto punë të mira.

Unë në emër të grupit po flas dhe po them se nuk jam kundër, sepse këto janë gjërat më të mira që po ndodhin në Komunën tonë dhe këto janë mushkëri të qytetit.

Mirëpo destinacioni nuk po më pëlqen, Arsyeja është se lagjja “Dardania I” ka një kohë të gjatë që është duke pritur për një projekt të tillë dhe mendoj që i ka të gjitha parakushtet që ky destinacion të shkojë atje. Mirëpo sidoqoftë ne jemi Gjilan, jemi Komunë dhe duhet ta përgëzojmë këtë projekt, por unë personalisht nuk jam i kënaqur.

Nevzad Rushiti- edhe unë po përshëndes këtë projekt, por më intereson kur do të bëhet zbatimi i këtij projekti? Është paraparë në dy faza apo më gjatë? Këtu duhet të thuhet kur fillon dhe kur mbaron?

Unë në material nuk e kam gjetur kush e ka bërë projektin, por më duket se njëherë kemi thënë se ajo firmë më nuk do të merr projekte në Gjilan. Këtu më duket se është thyer një parim. E dyta është se infrastruktura nuk shihet qartë në atë projekt edhe pse drejtoresha u mundua të na jep disa sqarime.

Bahrie Veseli- unë desha ta plotësoj kolegun tim dhe po pyes se sa është afati kohor për të përfunduar ky projekt?

Florinë Zymberi- unë mendoj se është projekt mjaft i mirë dhe në dobi të qytetarëve dhe është fat i mirë që kjo parcelë tash përdoret si hapësirë gjelbëruese dhe rekreative për këtë pjesë.

Në këtë pjesë nga dukja e jashtme ka qenë një pozicioni i keq dhe tash është kënaqësi që është bërë një projekt i tillë dhe është legjitimuar kjo. Besoj se kjo lagjeje do ta kenë një projekt me sipërfaqe rekreative, sportive, gjelbëruese etj.

Ramiz Ramadani- unë po filloj me atë sllajdin ku shihet se paska qenë një takim me komunitetin e asaj lagjeje. Mirëpo ne me drejtoreshën jemi marrë vesh që t’ i kemi edhe procesverbalet, sepse po duam për ta ditë sa janë në harmoni kërkesat e banorëve të kësaj pjese me këtë projekt. Ne këto gjëra i kemi kërkuar me kohë, por tash po i lëmë në përgjegjësi të drejtoreshës dhe në përgjithësi të drejtorisë.

Ajo zonë definitivisht ka nevojë për një zonë të gjelbëruar dhe ne do ta mbështesim, por në komitet kam kërkuar që a ka konteste private, por po kërkojmë edhe njëherë që të lirohet çdo uzurpim nëse rastësisht ka. Gjithashtu atë që e tha Nevzadi ishte shumë me vend, sepse kemi pas kërkuar që projektuesi i Planit “Fidanishtja” mos të merr më projekte në Komunë për shkak të jo seriozitetit. Kësaj here nuk kemi vërejtje, por ne më parë kemi marrë qëndrim që këtij projektuesi të mos i japim më projekte.

Shukrie Rapuca- gjithashtu edhe unë e mbështes këtë projekt i cili është shumë i qëlluar, por mendoj se padrejtësisht deri më tani është vonuar realizmi i këtij projekti. Drejtoresha e paraqiti projektin, por më duket se gjatë paraqitjes pati shumë objekte, por unë e di se ku është planifikuar ai projekt dhe mendoj se është hapësirë e vogël për tëra ato objekte, por përsëri mendoj se ka të drejtë, sepse është profesioniste, por unë mendoj se si hapësirë gjelbëruese duhet të jetë një park kur dihet se aty është një dendësi e madhe e shtëpive dhe një park i gjelbëruar do t’iu kishte përshtatur qytetarëve të asaj lagjeje.

Tahir Arifi- unë do të dëshiroja për ta parë këtë projekt ashtu si e kemi ndarë në katër zona, mirëpo pjesa të xhamia ka qenë desh të mbetet edhe për nevoja të xhamisë edhe për ndonjë manifestim të lagjes. E dyta është parashikuar një hapësirë e vogël për taksì, sepse këtë plato mandej do ta zënë taksitë. Në vazhdim të fjalës së tij z. Arfi kërkoi disa sqarime në këtë projekt duke i parë në kino-projektor.

Bharie Mahmuti- zona e parë është kryesisht e destinuar për qëndrim (plato), për qytetarë, zona e dytë është për hapësira sportive, zona e tretë është e planifikuar për çerdhe, ndërsa zona e katërtë ku konfiguracioni i terrenit është shumë i thjeshtë është i planifikuar një restorant.

Sa i përket kohës së implemtimit, ne shumë shpejtë do të fillojmë pasi që kemi konkurruar në Ministri të Mirëqenies Sociale të cilët e kanë një fond për zhvillim të hapësirave publike dhe shumë shpejtë do të fillojë faza e zbatimit.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të këtij propozim –vendimi?

Aprovohet propozim –vendim i pikës d; Propozim vendimit për miratimin e zgjidhjes urbanistike të hapësirës publike “Parku “-në lagjen “Arbëria, me shumicë të votave të anëtarëve të Kuvendit, kurse 1 ishte abstenim,.

E. Propozim vendimi për miratimin e Marrëveshjes parimore për kompletimin e ngastrave ndërtimore përmes ndërrimit të kufijve të parcelave dhe rregullimit të marrëdhënieve pronësore-juridike-Zona “Fidanishte”

Sali Fazliu- plani rregullues urban “Fidanishte” i aprovuar nga KK, më datë 30.5.2011, parasheh që në këtë zonë të ndërtimit të bëhet ndërtimi i objekteve me karakter të përgjithshëm publik me objekte përcjellëse, siç janë objektet e arsimit, edukimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, sportit administratës publike, rrugëve dhe hapësirave të gjelbëruara, shtigjeve për këmbësorë, rrjet të kanalizimit dhe infrastrukturë tjetër përcjellëse.

Në këtë zonë të ndërtimit Komuna e Gjilanit është pronare e një zone kadastrale me sipërfaqe prej mbi 15.317 m² parcela në fjalë iu është dedikuar Qendrës së Paqes “Don Bosko”, ku është parapara ndërtimi i një shkolle të mesme profesionale, me tërë infrastrukturën përcjellëse të cilat i përmendëm më parë.

Mirëpo parcela në fjalë është e mjaftueshme për realizimin e këtij projekti, por forma gjeometrike e kësaj parcele është jofunksionale dhe jo e përshtatshme për zbatimin e këtij

projekti. Në kufi me këtë parcelë gjendet zona kadastrale, 4961 me sipërfaqe të përgjithshme prej 10.884 m² e cila aktualisht është në shfrytëzim të ndërmarrjes “Kosova Commerce” e cila është privatizuar gjatës procesit të privatizimit. Edhe kjo ngastër nuk ka formë të rregullt dhe është jofunksionale për implementimin e këtij plani. Me qëllim që të krijojmë kushte më të mira për zbatimin e këtij plani urbanistik “Fidanishte”, kryetari i Komunës e ka formuar një komision prej 5 anëtarëve i cili është marrë me këtë çështje. Ne si komision pas verifikimit në terren kemi dal me një propozim, për parcelimin dhe rregullimin e kufijve të këtyre dy parcelave.

Në vazhdim të fjalës së tij z. Fazliu dhe edhe sqarime të tjera duke e sqaruar planin më detalisht, të cilat arsyetime anëtarët e Kuvendit i kanë edhe në material të seancës. .

Arianit Sllamniku- kjo iniciativë e cila është propozuar dhe të cilën e dëgjuam, sipas mendimit tim është për t’ia rregulluar dikujt terrenin, terren i cili për mendimin tim është edhe i partisë së cilës i takoj. Kjo iniciativë është në kundërshtim me parimet të cilat kanë të bëjnë me identitetin qytetarë të Komunës së Gjilanit. Këtu e kemi edhe dokumentin e Qendrës “Don Bosko” dhe i cili në pikën “C” të vizionit dhe strategjisë zhvillimore të planit 2012-2015 të “Don Boskos”, pika “C”, paragrafi i pestë thotë: “ të promovohet sistemi preventiv i “Don Boskos” të ndihmohen fëmijët, të rinjtë e Kosovës që të rriten si qytetarë të ndershëm dhe besimtarë të mirë”! Unë pyes “besimtarë të mirë” të kujt?

Në fillim pika e parë thotë:” Qendra Socio Edukative “Don Bosko” është pjesë e Kongregatës Sinaziane dhe si pjesë e tillë pjesë e Kishës Katolike dhe çdo veprimtari që zhvillon kjo qendër është në përputhje me të drejtat kanonike të Kishës dhe Kushtetutën e Kongregatës Sealziane. Për këtë arsyeje unë këtë e kam si shqetësim të ngritur dhe i dyti argument është se vetë projekti “Don Bosko” ka filluar në një parcelë të kontestuar dhe është në proces gjyqësor. Pronarit iu ka marrë toka dhe është dokumenti i vitit 1935.

Unë propozoj që ky projekt dhe këto iniciativa nuk i bëjnë dobi kësaj popullate, sidomos fëmijëve tanë. Unë nuk jam kundër, por me këso dokumente që unë i posedoj, kurse pronari është këtu dhe po na dëgjon, për mua kjo është jo reale dhe në dëm të qytetarit.

Izmi Zeka- nëse gjykata vendos diçka me tapi të kohës së Turqisë, ai e fiton kontestin dhe nuk ka ndonjë problem këtu. Mirëpo ne deri më tash tërë dokumentacionin e kemi në rregull.

Qemajl Mustafa- së pari të sqarojmë që për hir të një informimi të drejtë se në këtë proces nuk ka pasur ndonjë ndalesë gjyqësore. Ky personi që po hyn aty mund të jetë pretendent për pronën, por me dokumentet aktuale, ai nuk është pronar i asaj parcele. Pronar i tokës ka qenë AKP, gjegjësisht ka qenë pronë shoqërore e Mekanizmit dhe ish Kombinatit Bujqësor “Mlladost” e cila është kompensuar me tokën publike të Komunës. Janë dhënë 15 hektar tokë jashtë zonës urbane për t’i kthyer 1.5 hektar në zonë urbane dhe tash është ndërrimi me një privatist. Kjo është manipulim, sepse dokumenti i vitit 1935 dhe publikimi i këtij dokumenti në KK nga një këshilltar i Komunës është tendencë për ta manipuluar publikun.

Sa i përket “Don Boskos”, asgjë komuniteti “Don Bosko” nuk fsheh asgjë, ajo është ashtu si e lexoj ai këshilltar. Është komunitet përbrenda kishës katolike, është komunitet shumë i shpërndarë në botë me 5 mijë njësi edukative të kësaj natyre si qendra socio-kulturore.

Një qendër e tillë është në Prishtinë, dy në Shqipëri dhe një në Podgoricë, kurse e dyta në Kosovë është kjo në Gjilan. Nga kjo qendër dalin profesionistë të mirë me shkolle të mesme dhe qëllimi është që të rinjve tanë t’iu ofrojmë mundësinë për t’u shkolluar profesionalisht. A ka ndikim fetar? Ata asgjë nuk fshehin, është një ndikim bile dhe jo i tërthortë, por edhe direkt fetar. Mirëpo nuk do t’i detyrojë askush për të bërë lutje, për të predikuar dhe respektuar edhe ritet fetare. Dhe natyrisht që ai që e udhëheq Qendrën “Don

Bosko' e mban edhe kryqin jashtë. Mirëpo ne duhet ta kuptojmë një realitet në Kosovë, sepse ne kemi shumë nevojë për miq, kemi nevojë shumë për investime dhe kemi nevojë për ardhje të investimeve të cilat e edukojnë njeriun tonë dhe e bëjnë profesional. Nëse këtë e bën Kisha katolike, urime i qoftë, por nëse këtë e bën BI-ja edhe asaj urime i qoftë, sepse ne kurrë nuk ia kemi mbyll dyert as BI-së.

Elisah Ymeri- edhe unë e kam një dozë kundërshtimi ndaj Arianit Sllamniku, sepse ai e tha se këtu ka edhe çështje fetare, por unë mendoj se ne jemi shtet laik dhe te kjo çështje nuk kemi se çka të flasim. Kultura jonë është mjaft e lartë në aspektin fetar dhe neve asnjëherë nuk na kanë interesuar këto gjëra dhe për mua janë të njëjta si katolicizmi si myslimanizmi dhe nuk duhet të na pengojë asgjë ajo. Nuk duhet krijuar këso ndasi dhe sa për informatë të tuajën në Prishtinë funksionon kjo shkollë dhe atë për mrekulli. Kjo shkollë ka për qëllim edukimin e nxënësve në aspektin privat për aftësime të fëmijëve për zanate dhe është mjaft funksionale dhe kam edhe shokë që aty japin mësim dhe aty asnjëherë nuk është e involvuar feja. Feja është çështje individuale dhe askush askujt nuk mund të ndikojë te personi tjetër. Kjo shkollë nuk ka karakter fetar, por në tërësi ka karakter edukativ dhe kjo neve nuk duhet të na shqetësoj.

Arianit Sllamniku- së pari po i përgjigjem Elisaut se unë në asnjë deklaratë deri më sot që nga viti 2009, prej kohës që jam në subjekt politik nuk e kam asnjë rresht kundër ndasive fetare. Por edhe kurrëgjë dhe askush nuk tha që është kundër konceptit fetar krishterë në Gjilan.

Mirëpo jam kundër pronësisë dhe zhvillimit të këtij projekti, projekt i cili në hulumtime të kësaj qendre, pas pikës 4 është studimi i "Don Boskos" për gjendjen në Gjilan ku thotë: "janë përparësitë, dobësitë dhe rreziqet. Për rreziqet flitet në pasuesin e dytë, vazhdimi i situatës së rënduar ekonomike dhe siguria e qytetarëve për të ardhmen e tyre. Nga kjo do të thotë se po na paraqitet një projekt si një lloj shpëtimtari i qytetarëve dhe të ardhmes tonë.

E dyta pasuesi i fundit pikërisht te këto rreziqe thotë: "vazhdimi i mos përputhjes së arsimit të Kosovës me zhvillimin shoqëror dhe ekonomik" Nga kjo po na dalka se ky projekt qenka një urë lidhëse ndërmjet zhvillimit ekonomik në Kosovë dhe shoqërisë në përgjithësi.

Në vazhdim të fjalës së tij z. Sllamniku pati edhe disa vërejtje në disa pasuese në këtë projekt.

Unë jam i obliguar, sepse jam i zgjedhur për t' i ngrit këto çështje, kurse e juaja është të votoni apo mos votoni. Këtë mos ta marrin personale askush, sepse unë do t' iu dal borxh nëse është diçka e paqartë.

Sa i përket dokumentacionit ky dokument nuk është i manipuluar, por është dokument i pranuar nga gjykata dhe është dokumenti i dytë për të cilin është duke vazhduar seancat gjyqësore e që ju po thoni nuk ka konteste gjyqësore për këtë hapësirë.

Qemajl Mustafa- gjykata vendos ndalesë, gjykata kur e fillon një proces dhe pretendon se ai proces mund të rezultojë me kontestim të së drejtës nëse njëres nga palët, vendos ndalesë për aktivitet të mëtejshëm në pronën e caktuar. Një ndalesë të tillë, Komuna nuk e ka marrë dhe AKP-ja nuk e ka marrë.

Elisah Ymeri- Arianiti deshi të thotë diçka, por në një mënyrë më ofendoj, sepse ironizoi duke qeshur dhe pastaj the se shkolla del si shpëtimtare. Unë po i tregoj që në çastin kur bëhet një projekt, bëhet edhe analiza e rrezikut, përparësitë, fitimet dhe pastaj dilet me një projekt. Këto analiza janë bërë edhe në këtë rast, prandaj dua t' i them parafolësit se në Gjilan nuk ka shkollë profesionale. Unë e kam kryer drejtimin e elektoratit në shkollë të mesme e cila shkollë shumë pak na ka aftësuar, kurse pas përfundimit të Don Boskos, nxënësit dalin si instalues dhe aftësohen për shumë zanate të tjera. Kjo është shkollë e

zanateve për të cilën Gjilani ka shumë nevojë. Nuk po dua ta mbrojë, por mos t' i japim karakter fetar dhe kjo është shkollë profesionale për të cilën kemi nevojë si Gjilan dhe tërë Kosova.

Sadudin Berisha- ne si Kuvend kemi debatuar disa herë çështjet e zhvillimit ekonomik të asaj pjese të Fidanishtja. Kemi marrë një vendim shumë më herët për ndërrim të pronave për realizmin e disa objektivave tona. Jemi pajtuar të gjitha subjektet politike për një ndërrim të tillë me qëllim të zhvillimit të një aktiviteti të tillë. Çështjet kontestuese pronësoro-juridike që mund të kenë të drejtë që mund të kenë të drejtë ish pronarët, unë patjetër se do t' i mbështesë edhe si grupim politik edhe si individ, nëse ajo e drejtë realizohet përmes institucioneve të vendosjes siç janë gjykatat. Ne si familjar dhe trashëgimtar të disa parcelave jemi të gjithë dhe unë e di që familja ime i ka mbi 5-6 hektar dhe lokal e afariste që janë marrë me procedura të dhunshme. Ne në këtë rast i kemi dy dokumente të cilat janë legale, do të thotë e kemi KK-në dhe një dokument që AKP, që ia ka shit një pronari të ri një titullari të ri siç është "Kosova Commerce". Unë në Komitetin për Politikë dhe Financa kam kërkuar sqarime të cilat më janë dhënë, por jo mjaftueshëm, sepse me këtë ndërrim të kufijve të parcelave e që detyrimisht duhet të zbatohen, sepse ndryshe nuk do të mund të zbatohen objektivat e njërës dhe tjetrit, a ndërron plani i miratuar i parë i Fidanishtes? A ndërron plani i parë miratuar i Fidanishtes, është fjala për atë jo për atë që ka ndërruar më vonë i cili është votuar edhe përkundër vërejtjeve që janë dhënë nga ministria përkatëse. Nëse nuk ndërron ai plan, ne do të duhej ta mbështesim, sepse në mënyrën figurative si është dhënë me parcela të ndryshme as njëri as projekti tjetër nuk do të mund të realizohen. Kjo është ajo që kërkon grupi i LDK-së në Kuvend të thuhet : " nuk ndryshon plani dhe marrëveshja për ndërrim përmes pronarit të ri në këtë rast "Kosova Comercit" dhe KK-së. Nëse është kjo kështu ne e mbështesim këtë projekt që të realizohet si i tillë.

Bujar Nevzadi- unë personalisht kam qenë dhe e kam vizituar Qendrën "Don Bosko" në Prishtinë së bashku me shefat e grupeve parlamentare. Është mirë që të dëgjohet edhe zëri i shefave të grupeve dhe i të gjithë drejtorëve të Qeverisë Komunale. Në Prishtinë e kemi parë një qendër e cila askund në Kosovë nuk është, por nuk e kam parë as në Itali dhe Greqi në kohën kur kemi qenë në vizitë. Kjo qendër i duhet Gjilanit, prandaj unë e falënderoj kryetarin që ka pasur durim dhe ka punuar për këtë qendër një kohë të gjatë. Ne si DA e mbështesim dhe e përkrahim, sepse kjo qendër do të jetë në shërbim të nxënësve tanë dhe unë do të jem shumë i lumtur nëse i epet mundësia fëmijës tim që t' i vazhdojë mësimet në atë shkollë. Kjo qendër i ka mjetë mësimore më moderne në botë, prandaj unë kërkoj që të aprovet ky propozim-vendim.

Qemajl Mustafa- të jetë e qartë se ekziston vetëm një plan i Fidanishtes dhe ai është Plani që herën e fundit KK e ka miratuar dhe nuk ka dy plane! Çështja e planeve rregulluese, lexoni ligjet mirë është çështje e nivelit lokal të vendim-marrjes. Kjo nuk ka të bëjë asgjë me ministrinë, keni shkuar në ministri keni bërë kërkesa në MPL, ajo iu ka dërguar në Ministri të Ambientit e cila nuk ka reaguar, sepse e dinë shumë mirë që vendim – marrja për planet rregulluese është në nivelin lokal.

Sadudin Berisha-shumë i qartë isha dhe e thash që KK pas reagimit që e ka bërë shumë qartë nga ministria përkatëse që nuk ka pasur të drejtë të ndërhyjë para kohës ligjore për ndërrim të planit detal urbanistik në Fidanishte. Ju e keni kthyer e keni miratuar me shumicë pa pëlqimin tonë. Unë e thash se ne nuk jemi kundër realizimit të këtyre projekteve, nuk jemi kundër ndërrimit të pronave, por për ne është me rëndësi që të thuhet këtu se ky plan i cili

sot është në diskutim nuk është në kundërshtim me versionin e parë të miratuar edhe me grupin tonë për planin e parë urbanistik “Fidanishte”

Qemajl Mustafa- nuk është KK, z. Sadudin dëshirë individësh dhe vullnet politik i individëve. Ky Kuvend e ka miratuar planin dhe më së pari ka marrë leje prek Kuvendit për një revidim të pjesshëm. Është hap mundësia për debat, iu është dhënë mundësia të gjithëve, është mbyll në proces normal në këtë Kuvend, pavarësisht dëshirës së Sadudit dhe grupit të tij politik.

Selim Selimi- unë po ndiej si obligim për ta paraqitur obligimin tim personal, por edhe nga elektorati për Qendrën “Don Bosko”. Procedurat ka arrit deri këtu, por gjithmonë është biseduar se çfarë misioni, vizioni do të ketë dhe kjo u tha më herët. Mirëpo mbi të gjitha ne jemi përfaqësues të një feje që thërret për paqe, harmoni, dashuri dhe tolerancë.

Duke u nisur nga kjo ka ardhur deri te kjo procedurë dhe është votuar dhe deri te kjo ka ardhur nga toleranca islame që e predikon. Këtu u përmend edhe avancimi i shkollës profesionale, por unë përsëri e kam një rezervë, sepse në hyrje të qendrës do të jetë kryqi. Ajo jo për të gjithë, por për disa është një shqetësim, prandaj edhe unë e ndiej këtë shqetësim e paraqes këtë shqetësim dhe unë nuk e votoj këtë propozim- vendim.

Izmi Zeka- Kush për aprovim të pikës (E)?

Aprovohet pika (E) e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e Marrëveshjes parimore për kompletimin e ngastrave ndërtimore përmes ndërrimit të kufijve të parcelave dhe rregullimit të marrëdhënieve pronësore-juridike-Zona “Fidanishte”, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, 3 ishin kundër, kurse të tjerët abstenuan.

F. Propozim vendimi për shpalljen Zonë me interes të përgjithshëm Publik,

Sali Fazliu- edhe kjo pikë e rendit të ditës ka të bëjë me punën të cilën e ka bërë ky komision. Në terren kemi vërejtur se tri parcela në këtë zonë të ndërtimit, tri parcela ende evidentohen në emër të Kombinatit Bujqësor “Mlladost”, kurse ½ e tyre është në emër të Mekanizmit të Prishtinës.

Sipas planit rregullues urbanistik Fidanishte këto parcela janë të dedikuara për rrugë dhe për shteg të këmbësorëve. Sipërfaqja e këtyre tri parcelave është afër 45 ari e 73 m dhe për këtë arsyeje është paraqit nevoja që këto tri parcela të shpallen zonë me interes të veçantë në mënyrë që kryetari i Komunës në bazë të autorizimeve të cilat i posedon nga KK, të hyjë në bisedime për këmbimin e këtyre tri pronave me AKP-në.

Izmi Zeka- kush për aprovim të kësaj pike?

Aprovohet pika (F) e rendit të punës: Propozim vendimi për shpalljen Zonë me interes të përgjithshëm Publik, me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

G. Informatë nga Drejtoria e Arsimit për kriteret e pranimit të nxënësve në klasën e parë të shkollës fillore dhe Informatë për kriteret e pranimit të punëtorëve në arsim,

Arben Maliqi- unë e kam kërkuar këtë informatë në Komitetin për Politikë dhe Financa që të kemi një informatë të tillë, sepse për arsim duhet dhe gjithmonë ka çka të bisedohet, sepse ata fëmijë nesër na zëvendësojnë neve. Unë e them me plotë përgjegjësi se DA është një drejtori mjaft sfiduese dhe ka një mal me probleme. Unë më tepër do të flas për pranimin e

fëmijëve në klasën e parë. Unë e di se në këtë drejtim ka vështirësi ka probleme, por të thuhet singlerisht, unë nuk lejoj që çfarëdo mësuesi të ma mësoj fëmijën nuk e lejoj. Këtë po e them sepse kemi shumë arsimtarë i cili është në moshën 60 vjeçare dhe ai tash nuk ka mundësi për t' i kap gjërat e reja. Ai ka mbet aty ku ka qenë dhe fëmija i im nuk lejoj që ta mësoj ai arsimtar. Mirëpo kemi edhe arsimtarë të cilët nuk i plotësojnë kriteret, sepse për të qenë mësues i mirë duhet ai person të ketë shumë kapacitete. Unë nuk mund të bëhem mësues i mirë dhe nuk jam i aftë për të punuar me filloristë, sepse nuk kam prirje për vizatim. Kërkoj që ta gjeni në model që së paku fëmijët t' i regjistrojmë aty ku ne kemi dëshirë. Kjo është kërkesa ime.

Saranda Bllaca- sa i përket kësaj pike, në realitet këtu janë dy pika të rendit të punës. Për pikën e parë për kriteret e pranimi të nxënësve në klasën e parë unë këtë e kam mbështet në komitet e cila është mbështet edhe nga anëtarët e tjerë dhe ka kaluar.

Mirëpo për pikën e dytë për kriteret për pranim të punëtorëve arsimor, nuk e di si ka ardhur drejt në Kuvend për pa kaluar fare në Komitet të Arsimit. Ka qenë i planifikuar javën e kaluar Komiteti i Arsimit dhe pa dhënë arsye time është shtyrë mbledhja e komitetit dhe ne njoftuar me anë të imelles. Unë u habita kur e pashë këtë pikë në mbledhjen e seancës dhe nuk e kam të qartë pse është anashkaluar komiteti?

Unë mendoj se për këtë ka se çka të debatohet dhe në emër timin dhe të grupit të LDK-së jemi për ta rikthyer këtë pikë në komitet për t' i shqyrtuar dhe jemi për t' i ndryshuar këto kriteret. I kemi disa propozime tona të cilat kërkojmë t' i bisedojmë në komitet, e më vonë edhe në Kuvend.

Rashit Sahiti- unë kam vetëm një pyetje për kryetarin? Këtu në këtë Kuvend u pat marrë një vendim për poste të dyfishta për punëtorët arsimor të cilët punojnë në dy shkolla ose dy shtete. Me atë rast kryetari pat dhënë premtime se këto dukuri do t' i ndërpres.

Unë po pyes a është marrë ndonjë iniciativë në këtë drejtim apo jo?

Është një rast kur një mësimdhënës punon në një komunë tjetër e udhëheq një shkollë dhe përsëri i mban orët edhe në një shkollë të Gjilanit. Por edhe më tragjike është se ky person është edhe kujdestar klase në një shkollë tjetër ku nuk punon fare.

Gjithashtu edhe një drejtor i cili i ka mbi 1300-400 nxënës i mban edhe 4 orë mësimore në atë shkollë. Drejtori i DA duhet të marrë masa ndaj këtyre mësimdhënësve, kurse kryetari duhet të na jep përgjigje se a ka marrë ndonjë masë ndaj këtyre mësimdhënësve?

Shkëlqim Latifi- unë desha të ndërlihem me Sarandën dhe në mbledhjen e komitetit të fundit e kemi pasur në rend të ditës edhe kriteret e pranimi të punëtorëve të arsimit, drejtori ka kërkuar për t' i analizuar mirë këto kriteret. Kjo është bërë për arsye se DA është sponzorizuese e komitetit dhe mendoj se kemi kohë të mjaftueshme dhe gjatë javës do të kemi kohë për t' i analizuar të cilat propozime pastaj do të vijnë në Kuvend.

Tahiri Arifi-unë mendoj se drejtori ka bërë shumë mirë që i ka sjell këto kriteret në Kuvend, sepse pas çdo pranimi dhe intervistimi të punëtorëve, Kuvendi ballafaqohet me probleme të cilat kanë dal gjatë atij procesi. Unë mendoj se sot duhet të diskutohen këto çështje për faktin se unë nuk e di se a do të keni mbledhje të Kuvendit para se të shpallet konkursi për mësimdhënës. Kuvendarët do të duhej t' i dinë kriteret dhe unë mendoj se komiteti është institucion i vogël për të marrë një vendim për këto kriteret.

Elisah Ymeri- unë e lus komitetin që të mbajnë një takim dhe të debatojë për çështjen e kriterëve për punësim, aty ku është familjet e dëshmorëve. Duhet të dihet dhe shënohet te

familjet e dëshmore se familje e ngushtë është i biri e bija, babai, e ëma, dhe jo të hyjnë edhe vëllai dhe kushërinjtë.

Ta keni parasysh, sepse kjo po keqkuptohet.. Të precizohet familja e ngushtë, por kush është familja e ngushtë?

Bujar Nevzadi- sa i përket pikës së parë lidhur me regjistrimin e nxënësve në klasë të parë, në komunat tjera e sidomos Prishtina ka që pesë vite që këto kriterë të cilat i kemi përpiluar në këtë vit. Ne edhe vitin e kaluar i kemi pranuar në "S. Hallaç" me këto kriterë dhe në bazë të analizave të DA kemi pasur rezultate. Nuk pajtohem ma atë që e tha Arben Maliqi se unë vetë dua për ta zgjedh arsimtarin! Ne do të marrim masa ndaj atyre arsimtarëve dhe kryetari i Komunës e ka formuar një komision shtesë i cili do të punon me ata arsimtarë. I kemi pasur dy debate me arsimtarët e ciklit klasor me drejtorët e shkollave, me kryetarët e këshillave dhe të gjithë janë pajtuar me këtë propozim.

Ne kemi një program për regjistrim dhe nuk do të ketë mundësi askush ta regjistrojë fëmijën ndryshe nga programi të cilin e posedojmë.

Lidhur me pikën e dytë, për kriteret për punësim, brenda javës do ta mbajmë Komitetin për Arsim dhe aty do t' i analizojmë këto kriterë dhe do të bëjmë ndonjë plotësim dhe ndryshim.

Bahrie Veseli-është e vërtetë se është biseduar në Komitetin e Arsimit për kriteret për pranimin e nxënësve në klasat e para të cilat kriterë personalisht i kam përkrahur, por e kam kundërshtuar mënyrën e punës si është bërë! Këtë po e them se DA i regjistron të gjithë këta nxënës dhe ia dërgon shkollave listat me të cilin veprim, konsiderojmë se është një centralizim i pushtetit. Këtë regjistrim mund ta bëjnë vetë shkollat, programet janë, arsimtarët të gjithë janë pranuar për programet e informatikës dhe këto punë duhet t' i kryejnë vetë drejtoritë e shkollave.

Ne jemi dëshmitar të përditshëm dhe po vërejmë se shkollat në tërësi janë të zhveshura nga kompetencat dhe një shkollë nuk mund të merr masa ndaj ndonjë nxënësi edhe nëse i tejkalon normat e mirësjelljes.

Gjithashtu deri më sot ende nuk është marrë asnjë masë ndaj ndonjë arsimtari i cili nuk ka qenë në nivel. Për këtë arsyeje kërkojmë që të respektohet kodi i mirësjelljes dhe ligji që është në fuqi për t' u vetëdijesuar edhe arsimtarët që të jenë në nivel të detyrës.

H. Informatë mbi menaxhimin e parkingjeve nga shoqatat e dala nga lufta,

Arben Mehmeti- kjo është një kërkesë e jona për ta debatuar në rend të punës së seancës, mirëpo në këtë formë si është sjell si informatë ka tjetër karakter. Për këtë arsye ne kërkojmë që kjo pikë të trajtohet edhe në ndonjë seancë të radhës për shkak se mungojnë informacionet më të rëndësishme për këtë çështje. Ne kemi kërkuar një raport më detal nga Shoqata e Veteranëve të Luftës, mirëpo ne e kemi marrë vetëm një raport, por edhe këtë e kemi marrë sot. Ne kemi informata se Shoqata e Veteranëve të Luftës këto parkingje ai ka dhënë në shfrytëzim dikujt tjetër, për të cilën gjë ne nuk jemi njoftuar dhe nuk kemi njohuri si anëtarë të Kuvendit. Gjithashtu neve na është desh ta kemi këtu edhe Marrëveshjen e Komunës me shoqatën për të parë se në çfarë forme ka qenë desh t' i menaxhojë ato parkingje dhe realisht për të parë ne se si është bërë ai menaxhim.

Neve na mungon marrëveshja e Komunës lidhur me atë se çfarë të drejta ka pasur shoqata lidhur me këto parkingje të cilën ne nuk e kemi, është kërkesë e tërë grupit që në seancën e radhës t' i kemi tërë dokumentacionin komplet lidhur me menaxhimin e këtyre parkingjeve.

Parkingjet te Kadastri dhe te QKMF-ja ka qenë desh që të lehen për nevoja emergjente të qytetarëve dhe jo të bëhet parkimi me pagesë i veturave.

Është kërkesë e imja që për seancën e ardhshme t' i kemi të kompletuara të tërë dokumentacionin lidhur me menaxhimin e këtyre parkingjeve.

Izmi Zeka- në bazë të asaj çka u tha është mirë që në seancën e radhës të sillen tërë dokumentacioni dhe tash të mos hapet debat. Vendimi është i KK-së që ne ia kemi dhënë shoqatës, kurse për çështje të tjera ka përgjegjësi shoqata.

Ahmet Daku- unë e kam për obligim që t' iu njoftoj për mënyrën e menaxhimit të parkingjeve publike të KK-së të cilat parkingje që nga viti 2008 e këndeje ne si Shoqatë e Veteranëve të Luftës i menaxhojmë këto parkingje.

Organizata ka funksionuar dhe i ka menaxhuar këto parkingje në mënyrë shumë të kënaqshme dhe me këto të hyra ne kemi arrit t' i punësojmë disa invalid të luftës dhe veteranë të luftës, por kemi arrit që administrata të jetë më funksionale. OVL në Gjilan për afërsisht i ka 1 mijë anëtarë dhe disa prej tyre janë pjesëtarë të luftës si logjistikë dhe disa si mbrojtje civile. Kjo anëtarësi ka nevojë shumë të madhe si për punësim, banim, shërim ose rehabilitim. Ne kemi arritur t' i ndihmojmë me aq sa kemi pasur mundësi në ndërtimin e shtëpive në disa fshatra dhe në qytet.

OVL ka mjete për t' i ndihmuar këtyre familjeve në rast të vdekjes së ndonjë anëtarit të familjes duke ia heq shpenzimet e ceremonisë së varrimit.

Edhe ne si OVL kemi marrë pjesë në organizimet e ndryshme të Komunës si në manifestime kulturore, përkujtime, në projektin e varrezave të dëshmorëve etj.

Për çdo raport tjetër zyrtar tona janë të hapura dhe çdo subjekt mund të na vizitojë dhe të marrë informata sa herë të dëshirojë.

Arben Mehmeti- ne nuk jemi kundër asaj që të inkorporohen ata që kanë merita të veçanta, por kjo nuk dot ë thotë që të lejohet që të keqpërdoren pozitat, të bëhen shkelje ligjore, të keqpërdoren financat dhe kështu me radhë. Ne këtë kemi kërkuar që ta debatojmë në vendin ku duhet. Ne kemi një parking afër QKMf-së, por tash është krijuar një tjetër pranë Kadastrit në të cilin parking, qytetarët kanë nevojë për parking, mandej për të kryer punë dhe pas kësaj të shkojnë në punët tyre personale. Ne i kemi dhënë në shfrytëzim këto parkingje për shoqatën për shkak të respektit që kemi pasur dhe asnjëherë nuk kemi kërkuar kontroll, pikërisht për shkak të këtij respekti. Mirëpo tash informatën e kemi se ato parkingje iu janë dhënë në shfrytëzim një kompanie private e cila është e lidhur shumë ngushtë me pushtetin komunal dhe krerët e pushtetit komunal. Kjo na ka befasuar neve edhe si grup politik, por na ka befasuar ajo e drejta që e ka marrë shoqata që t' i japin në menaxhim disa parkingje një kompanie që ka një afërsi me kreun e Komunës së Gjilanit.

Kjo mënyrë e menaxhimit na bie në dilema për mënyrën e menaxhimit të këtyre parkingjeve.

Ahmet Daku- OVL në mbledhjen e mbajtur më 25.5.2012 ka caktuar një menaxher dhe asgjë tjetër. Unë iu garantoj se punëtorët janë të OVL-së dhe nuk iu ka dhënë asnjë kompanie dhe për këtë iu kam bërë ftesë që të vini në zyrë për t' i kontrolluar të tërë dokumentacionin.

Qemajl Mustafa- së pari nuk është mirë që për çdo gjë ta lakoni emrin e kryetarit të Komunës dhe të kreut të Komunës. Nuk është mirë, sepse kjo ka filluar që të bëhet pengesë edhe përkundër asaj që ligjet thonë që duhet të jemi 100% transparent për çdo hap të punës që po bëjmë. E keni në raport të OVL-së të hyrat vetanake nga parkingjet dhe ato mjete sillen nga 21 mijë euro në viti deri në 25 mijë dhe shihet shumë qartë se të gjitha ato mjete shpenzohen për paga të punëtorëve. Do të thotë shoqatës i mbesin shumë pak ose nuk i mbesin asgjë. Familjeve të veteranëve dhe dëshmorëve nuk i ka mbet asgjë për

ndonjë asistim. Qëllimi ka qenë për t' i funksionalizuar ato parkingje dhe për të inkasuar më shumë dhe përveç që të kompensohen punëtorët shoqatës t' i mbesin neto më shumë mjete.

I. Informatë në lidhje me tenderët për mirëmbajtjen verore të rrugëve dhe sinjalizimin horizontal dhe vertikal,

Arben Mehmeti- sa i përket kësaj ne e kemi marrë një përgjigje prej Zyrës së Prokurimit të cilën e falënderojmë, sepse ka dhënë përgjigje me një afat shumë të shpejtë. Mirëpo kjo është një informatë jo e kompletuar, sepse këtu ka qenë desh të jep të dhëna edhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe të kemi informata plotësuese. Tenderi për mirëmbajtje verore të rrugëve është një problem, sepse po i shohim rrugët se në çfarë gjendje janë në Komunë të Gjilanit. Po ashtu ne si Kuvend ka qenë desh ta kemi edhe një projekt të Drejtorisë për Shërbime Publike për ta ditur se në cilën kahe do të bëhen këto renovime të rrugëve, kush është organ mbikëqyrës i tyre dhe shumë çështje të tjera.?

Edhe sinjalizmi i përket Drejtorisë për Shërbime Publike i cili është një tender problematik dhe ne nuk e dimë si anëtarë të Kuvendit se si veprohet me këtë projekt?

Kërkojmë që të gjitha këto të dhëna të na dërgohen në adresë elektronike.

Nevzad Rushiti- unë nuk po i përsëris fjalët që i tha shefi i grupit, por drejtorin i këtij shërbimi asnjëherë nuk e kam dëgjuar që e ka dhënë një raport për çështje të mirëmbajtjes së rrugëve verore në Gjilan. Tash jemi në kohën kur na vijnë mërgimtarët dhe qarkullimi është i më madh dhe kemi problem me rrugët qarkore dhe askush nuk interesohet për ato rrugë pa marrë parasysh si e kemi gjendjen brenda në qytet. Tash kemi lëvizje të madhe të qytetarëve dhe kur e kam parë këtë pikë të rendit të ditës kam menduar se do të debatohet mjaft gjatë dhe do të dihet se çka është paraparë për t' u punuar. Për mua është vonuar ky projekt dhe për mua kjo nuk është asgjë nëse ne në muajin korrik bisedojmë për mirëmbajtje verore të rrugëve. Tash punët në teren nuk janë fare në rregull, nuk më intereson kush e ka marrë tenderin dhe procedurat e tjera.

Qemajl Mustafa – së pari t' i them se edhe unë kam pasur qëndrim kritik ndaj Zyrës së Prokurimit e cila është vonuar për një muaj së paku te shpallja e tenderit për këtë çështje. Ka qenë desh shumë më herët të shpallet dhe të parashihet se edhe mund të anulohet, por dhe mund të rivlerësohet, sepse është një organ në Prishtinë i cili mund të na kontestojë dhe ta kthejë prapë dhe me këtë rast ka ndodhur kjo. Ka qenë një përfitues, por është ankuar një tjetër dhe kështu ky tender është kthyer në ritenderim. Ky ritenderim na e ka marrë një kohë dhe atë së paku 20 ditë. Është vonuar pak kjo punë, por për këtë unë kam marrë një qëndrim që t' i shpenzojmë me ftesë për kuotim mbi 9 mijë euro për t' i mbyll gropat më të mëdha në qytet.

Arben Mehmeti- unë nuk do ta kisha kërkuar këtë informatë nëse këto do të ishin publikuar në faqen zyrtare të Komunës dhe është obligim i Zyrës për Informim që t' i publikojnë këto gjëra. Edhe një kërkesë e kam për kryetarin, sepse në bazë të informatave të disa qytetarëve një rrugë e cila është asfaltuar tash në Shillovë ishte një rrugë jashtëzakonisht mirë e punuar, prandaj është mirë që edhe në vende të tjera të bëhen këso punë të mira dhe jo vetëm nëpër minoritete. Kudo që punohet le të punohet mirë.

Nevzad Rushiti- mua po vjen keq kur po dëgjoj prej pozitës kur po thuhet:” kthehuni dhe shikoni se çka keni bërë ju”? Kjo nuk më pëlqen dhe nuk duhet të thuhet, sepse proceset gjithnjë lëvizin. Ne punojmë për të ardhmen çdo ditë dhe nuk e shohë të arsyeshme të kthemi prapa 5 vjet.

E lus kryetarin që të na jep përgjigjen pse nuk janë mirëmbajtur rrugët deri më sot, sepse tash gati ka kaluar sezona verore?

J. Informatë rreth zbatimit të Marrëveshjes së Komunës me “VIVA FRESH”, (shfrytëzimi i hapësirës publike te posta e vogël)

Arben Mehmeti- kjo është një kërkesë, sepse nga praktika që jemi duke e parë aty, ne kemi kërkuar më herët që t' i kemi këto dokumente dhe ta kemi edhe ne këshilltarët Komunal, marrëveshjen me Vivën. Kjo na ka ardhur sot, por nuk e kam të qartë pse me kohë nuk po na sillen dokumentet të cilat po i kërkojmë?

Ajo që na ka shtyrë për të biseduar për këtë çështje është se në vend të ngjarjes aty afër e kemi postën, kur para objektit të postës janë vendosur pengesa të hekurta nga kompania private e të cilat nuk do të duhej të ishin ato pengesa.

Unë e kam parë se në marrëveshje thotë se ajo hapësirë duhet të shfrytëzohet prej konsumatorëve të vet dhe prej qytetarëve. Mirëpo unë e kam parë aty tabelën që shkruan se parkimi lejohet vetëm për konsumatorë! Kjo është një shkelje e kësaj marrëveshje dhe esenca e kësaj kërkesë është që t' i bëhet me dije çdokujt që Komuna e Gjilanit duhet t' i shikojë dhe zbatojë marrëveshjet.

Unë kërkoj që të formohet një ekip nga kryetari i Komunës për të biseduar me udhëheqësin e kësaj kompanie për t' u zbatuar marrëveshja ashtu siç është e shkruar.

Qemajl Mustafa- së pari po e them se nëse para Hotelit shkojmë pas orës 22 e tutje të natës do t' i vërejmë së paku 7-8 vetura të parkuara. Nga kjo do të thotë se gjatë ditës atë hapësirë totalisht e okupojnë qytetarët e pandërgjegjshëm, por sidomos zyrtarët tanë të pandërgjegjshëm. Ne e kemi themeluar marrëveshje me Wivën dhe ai është shumë tolerantë, qytetari mund ta lejë veturën dhe nëse e len gjysmë ore dhe shkon, ajo nuk do të thotë asgjë.

Mirëpo disa qytetarë e lënë veturën aty tri orë ose tërë ditën, prandaj për këtë arsyeje e ka marrë një qëndrim. Mirëpo ai është edhe komercial, sepse ai ka investuar në infrastrukturë dhe 20 mijë euro në vit ia paguan Komunës. Po shihet nga OVL me shumë parkingje nuk fitohen mbi 20 mijë euro në vit. Vetëm prej atij parkingu Komuna i fiton 20 mijë euro në vit neto.

Arben Mehmeti- të gjitha ato që po thotë kryetari të gjitha qëndrojnë, por atë që e ka bërë ai në praktikë është në kundërshtim me këtë vendim të këtij Kuvendi. Në marrëveshje thuhet edhe për qytetarë, por në çastin që ai e ka publikuar tabelën aty, kuptohet se qytetari nuk ka se çka kërkon aty!

Të ndryshme

Imi Zeka- e kemi një çështje më urgjente nga Drejtoria e Shërbimeve Publike e cila paska kaluar në komitet dhe kjo është; **Vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësimin e palujtshmërisë për ndërtimin e rezervuarit të ri me kapacitet $V=3000m^3$ në lagjen “Kodra e Dëshmorëve” në Gjilan.**

Për këtë fjalën do ta ketë drejtori, sepse tek është me urgjencë.

Behar Mehmeti- në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike e kemi një kërkesë më urgjente dhe është një marrëveshje me Qeverinë e Zvicrës dhe Republikës së Kosovës në të cilën marrëveshje edhe komuna e jonë ka përfituar një donacion prej 1 milion e 460 mijë euro për ndërtimin e rezervuarit të cekur në kapacitet prej $3000m^3$ ujë.

Kompania e cila është fituese e projektit për projektimin e këtij rezervuari Kompania “Holingen” ka rrit një kërkesë nga kjo kompani që deri më 16 korrik që ne si Kuvend duhet të dalim me një propozim-vendim për shpallje të asaj zone me interes publik.

Pjesa dërmuese e kësaj prone është komunale me përjashtim të dy ngastrave të cilat i taktojnë sektorit privat dhe është fjala diku për një sipërfaqe në total prej 23 ari e 61m², të cilat të dhëna i posedoni edhe në vendim që e keni në material të seancës.

Ju lus si anëtarë të Kuvendit që pasi që ky është projekt me shumë rëndësi për qytetarët dhe Komunën ta miratoni!

Arben Mehmeti- unë po pyes a nuk është kjo jo serioze se çka po ndodh në Kuvend? Problemi është i rëndësishëm dhe me këtë edhe ne pajtohemi, por tërë këtë debat ta bëjmë dhe ne mos ta kemi një dokument dhe mos të jetë si pikë veçantë është gabim.

Ne nuk jemi kundër kësaj, por është gabim shumë i rëndë që neve vetëm të na lexohet një dokument dhe të thuhet duhet ta aprovoni.

Izmi Zeka- kjo ka qenë me urgjencë dhe iu lus të deklaroheni se kush është për aprovim të këtij propozim-vendimi.

Aprovohet propozim-vendimi: për shpalljen e interesit publik për shpronësimin e palujtshmërisë për ndërtimin e rezervuarit të ri me kapacitet $V=3000\text{m}^3$ në lagjen “Kodra e Dëshmorëve” në Gjilan, me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

Tahir Arifi- unë e kam një kërkesë nga qytetarët për rrugën Gjilan – Preshevë, në vendin ku është hapur “Wiwa”, “Interexi” është një vend shumë i papastër dhe kërkoj që Higjiena t’i bartë mbeturinat më shpesh dhe mundësisht në orët e mbrëmjet t’ pastrojë dhe lajë me ujë ato rrugë, sepse po duken shumë keq.

Me këtë seanca i përfundoi punimet, në ora 14.00

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA